



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 465/4 Prot.

Tiranë, më 16.06.2021

V E N D I M

Nr.77, datë 16.06.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të vlerësimit periodik, Korrik-Dhjetor 2020, të nëpunëses ***, me detyrë “Përgjegjëse e Sektorit të Financës”, në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; nenit 90/1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me disa pretendime për parregullsi në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën e vlerësimit 1 Korrik - 31 Dhjetor 2020, të paraqitur nga nëpunësja *****, me detyrë “Përgjegjëse”, në Sektorin e Financave, në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Vërej se:

Nëpunësja civile ***** , nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 465 prot., 13.04.2021, ka ngritur disa pretendime për parregullsi të kryera ose të lejuara në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën e vlerësimit 1 Korrik - 31 Dhjetor 2020.

Për efekt të kryerjes së hetimit administrativ, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 465/1 prot., datë 07.05.2021, “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e kërkesës së nëpunësit civil *****”, për rregullshmërinë e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën 1 Korrik - 31 Dhjetor 2021”, është kërkuar nga institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, informacion në lidhje me praktikën e vlerësimit e nëpunëses në fjalë.

Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën sqaruese me nr. 537/1 prot., datë 17.05.2021, “Kthim përgjigje”, të Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, ka parashtruar argumentet e veta, në lidhje me faktet ku është bazuar procesi i vlerësimit, për arritjen e konkluzionit për vlerësimin e nëpunëses në nivelin 3, “Kënaqshëm” prej eprorit Zyrtar Raportues.

Në shkresën në fjalë parashtrohet se në vlerësimin e nëpunëses *****, për 6-mujorin e dytë të vitit 2020, janë mbajtur parasysh sa më poshtë:

“... materializimi i procedurës së ndjekur për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunëses *****, për periudhën 1 Korrik – 31 Dhjetor 2020, është bërë mbi bazën e informacionit shtesë përmbledhës nga grupi i verifikimit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me nr. 1284/5 prot., datë 12.01.2021, drejtuar Kryetarit të KLSH-së, nga ka rezultuar se: “Nga ana e Përgjegjëses së Sektorit të Financës ***** nuk është zbatuar pika 2, e shkresës nr. 15/143, datë 17.12.2020, për dorëzimin e dokumentacionit si dhe pajisjeve e mjeteve të punës në inventar të z. Topalli brenda datës 18.12.2020”, shkelje këto që bien në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Vendimin e Kryetrait të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015, “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i ndryshuar, pika 10.5.14;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 12,13,37.

Në fund, është konkluduar se për arsye të konstatimeve dhe shkeljeve të rënda rekomandohet fillimi i procedurës disiplinore për nëpuënsen *****, me detyrë “Përgjegjëse e Sektorit të Financës në Kontrollin e Lartë të Shtetit”.

1. Materializimi i shqyrtimit të ankimit të ankueses, si dhe matësit e performancës për sjelljen e vlerësueshme profesionale për këtë nëpunëse, nga zyrtari autorizues është bazuar në sa më lartë, si dhe në informacionin paraprak të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm mbi mungesën e plotësisë, në dokumentacionin justifikues për shpenzimet për udhëtim dhe dieta; mungesë sistemi në kontabilitet të 215 “Mjete transporti”, për vlerën kontabël bruto 35,152,000 lekë; mungesa e ngritjes të Komisionit Verifikues për të gjitha mjetet e transportit të çrregjistruara provizorisht jashtë përdorimit nga të cilat tre mjete gjatë vitit 2019;

mungesa e përshkrimit të emërimit të inventarëve të nxjerra jashtë përdorimit, sasi të dhe vlerat kontabël të tyre, në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar etj.

2. Eprori direkt i nëpunëses *****, kur është larguar nga detyra e Sekretarit të Përgjithshëm (i cili ka dhe cilësinë e Zyrtarit Autorizues për nstitutionin, sipas legjislacionin për menaxhimin financiar), është zëvendësuar nga nëpunësi Altin Tafilaj (me detyrë të mëparshme “Auditues i Lartë”, në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, i komanduar të ushtrojë detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me urdhër të Kryetarit të KLSH-së) dhe vlerësimin e pjesshëm të punës, ky i fundit e ka bërë bazuar në materialet e mësipërme dhe pretendimin se prej nëpunëses në fjalë, nuk është realizuar zbatimi në afat të detyrave funksionale të Përgjegjësit të Sektorit të Financës”.

Shkresa e mësipërme, nuk është shoqëruar me materiale shtesë apo argumenta që të hedhin dritë mbi metodën e përdorur për vlerësimin e nëpunëses dhe argumentimin e shkaqeve që kanë ndikuar në uljen e nivelit të vlerësimit të saj, në krahasim me vlerësimet e mëparshme.

Megjithatë, nisur nga përmbajtja e dokumentacionit të mësipërm dhe atij që paraqiti e interesuara, arrihet në përfundimet e mëposhtme:

Së pari: Parametrat e renditur, si bazë për kryerjen e vlerësimit të 6-mujorit të dytë të vitit 2020, nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ndonjë element të procesit të vlerësimit të rezultateve të punës pasi, janë informacione jo përfundimtare (*paraprake*), të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe aq më tepër që, në rast se do të konsideroheshin të mirëqëna, do të ishin elementë që kanë të bëjnë me shkelje të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe jo me përcaktimet e nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

Së dyti: Pretendohet se eprori direkt i nëpunëses *****, kur është larguar nga detyra e Sekretarit të Përgjithshëm (i cili në këtë rast, paraqitet edhe si Zyrtari Autorizues, sipas legjislacionit për menaxhimin financiar), ka bërë vlerësim të pjesshëm të punës, për ankuesen për kohën që ai ka kryer detyrën e eprorit direkt të ankueses. Ky fakt nuk qëndron, pasi nuk rezulton që institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, të disponojë apo të na ketë paraqitur një akt të tillë dhe për këtë arsye ky pretendim nuk mund të mbahet parasysht.

Ky detyrim ligjor, bazuar në pikën 8, të Kreut III, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, duhet të ishte plotësuar nga ish Sekretari i Përgjithshëm i KLSH, zj. Luljeta Nano, e cila është liruar

nga shërbimi civil, për shkak të dorëheqjes nga detyra, në dt. 21.12.2020, pra pak ditë përpara se të plotësohej periudha e vlerësimit të 6-mujorit të dytë të vitit 2020 dhe prej kësaj date, deri në mbyllje të periudhës së vlerësimit dt. 31.12.2020 (pra, për 10 ditë), në vend të tij, është komanduar si Sekretar i Përgjithshëm, nëpunësi ***** , i cili ka kryer vlerësimin e punës së punonjësës ***** , për të gjithë gjashtë mujorin e dytë të vitit 2020, duke për zgjedhur vlerësimin në nivelin 3 “Kënaqshëm”.

Ankueja, pasi është njohur me këtë vlerësim, ka shprehur mospranimin e saj, duke parashtruar sidomos kohën e pamjaftueshme që ka patur eprori i saj i ri, për tu njohur me mënyrën si e kryente ajo detyrën dhe mungesën e vullnetit prej tij, që të njihej me ecurinë e mëparshme të punës së saj, prandaj bazuar në pikën 1, të Kreut V, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, ka kërkuar rivlerësimin e rezultateve në punë tek Zyrtari Autorizues.

Zyrtari Autorizues, bazuar në pikën 2, të Kreut V, të aktit nënligjor të sipërcituar, në përfundim, pa dhënë ndonjë argument ose spjegim, ka vendosur mospranimin e ankesës, duke rikonfirmuar qëndrimin e tij, në lidhje me vlerësimin e mëparshëm për nëpunësen*****.

Nga analiza e dokumentacionit të procesit të vlerësimit periodik në fjalë, konstatohet që jemi para një mosmarrëveshje e cila e ka origjinën në moskryerjen si duhet të detyrës nga ana e eprorit të mëparshëm të nëpunësës civile ***** , i cili kishte detyrimin që me rastin e dorëzimit të detyrës pas dhënies së dorëheqjes, të realizonte edhe vlerësimin për periudhën në të cilën ajo kishte ushtruar detyrën, si për nëpunësen në fjalë ashtu dhe për nëpunësit e tjerë të institucionit.

Mosplotësimi i këtij detyrimi, ka krijuar një boshllëk i cili ka patur ndikimin e vet në mënyrë të drejtpërdrejtë, në gjithë procesin e vlerësimit, duke i lënë në këtë mënyrë, hapësirë qëndrimeve subjektive, për vlerësime të sforcuara, nga nëpunës në detyrë, që nuk kishin dijeni të mjaftueshme për mënyrën e kryerjes së detyrës në kohën e mëparshme nga ana e nëpunësës në fjalë dhe krijimin e pengesave të padrejta për moslejimin e zhvillimit të karrierës së saj, në kohën e ardhme.

Që në këtë rast është arritur në një përfundim subjektiv të pabazuar dhe të paargumentuar me materiale shkresore e dokumentare, del sidomos nga shqyrtimi i gjithë vlerësimeve të mëparshme, për periudhën e vitit 2018, 2019 e 6-mujorin e parë 2020, nëpunësja ***** , është vlerësuar në nivele të mira, gjë e cila do të thotë se mendimi i eprores së saj, për gjithë periudhën e mëparshme, ka qenë se ajo i ka realizuar në nivele të mira gjithë objektivat e punës së saj dhe ka treguar një sjellje e qëndrim profesional të dalluar nga të tjerët, kështu që në kushtet kur nuk vërtetohet se ka ndodhur ndonjë oshilacion i papritur në

sjelljen e saj profesionale, nuk mund të jetë e arsyeshme që eprori zëvendësues, vetëm për pak ditë, të arrijë në një përfundim që ndryshon ndjeshëm nga ai i eprorit të mëparshëm.

Siç u tha dhe më lart, nëpunësja *****, duke mos qenë e qartë për mënyrën e vlerësimit nga eprori i fundit, ka kërkuar rivlerësim tek Zyrtari Autorizues, i cili bazuar në pikën 2, të Kreut V, të aktit nënligjor të sipërcituar, pasi ka shqyrtuar ankimin e nëpunëses, pa shënuar ndonjë argument ose spjegim, ka vendosur mospranimin e ankesës, duke rikonfirmuar qëndrimin e tij, në lidhje me vlerësimin e mëparshëm, në nivelin 3 “Kënaqshëm”.

Në lidhje me këtë qëndrim të Zyrtarit Autorizues, është dhënë një spjegim, nëpërmjet shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm në detyrë, me nr. 537/1 dt. 17.05.2021 “Kthim përgjigje”, në pikën 1, të të cilës thuhet:

“Materializimi i shqyrtimit të ankimit të ankueses, si dhe matësit e performancës për sjelljen e vlerësueshme profesionale për këtë nëpunëse, nga zyrtari autorizues është bazuar në..., në informacionin paraprak të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm mbi mungesën e plotësisë, në dokumentacionin justifikues për shpenzimet për udhëtim dhe dieta; mungesë sistemi në kontabilitet të 215 “Mjete transporti”, për vlerën kontabël bruto 35,152,000 lekë; mungesa e ngritjes të Komisionit Verifikues për të gjitha mjetet e transportit të çrregjistruara provizorisht jashtë përdorimit nga të cilat tre mjete gjatë vitit 2019; mungesa e përshkimit të emërimit të inventarëve në nxjerra jashtë përdorimit, sasisë dhe vlerat kontabël të tyre, në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar etj.”.

Duke shqyrtuar indikatorët e pretenduar, që janë përdorur në vlerësimin përfundimtar të nëpunëses *****, konstatohet se ato nuk kanë lidhje me mënyrën si konceptohet dhe ndërtohet procesi i vlerësimit të arritjeve dhe rezultateve në punë të nëpunësve civilë, përcaktuar në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

Në pikën 10, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, përcaktohet në mënyrë të shprehur se vlerësimi i sjelljes profesionale të nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mesme drejtuese, ka të bëjë me vlerësimin e :

- a) Gabimeve/saktësisë në punën e kryer;
- b) Realizimit në kohë të punës;
- c) Kolegjialitetit të marrëdhënieve;

- d) Gadishmërisë për punë në grup;
- e) Shpeshëtisë së orëve të punës jashtë orarit;
- f) Kërkesave për këshillim;
- g) Trajnimit dhe ngritjes profesionale;

kurse në shkresën e sipërcituar, flitet për një informacion paraprak të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, mbi disa mangësi në dokumentacionin justifikues për shpenzime udhëtime dieta, mungesa sistemimi në kontabilitet të disa mjeteve të transportit të çregjistruara, mungesë përshkrimi në inventarin e disa objekteve të dala jashtë përdorimit, etj.

Siç shihet, përshkrimi në mënyrë indikative i disa mangësive të pretenduara në punën e nëpunëses ankuese, janë ta pamjaftueshme për të arritur në një përfundim të saktë dhe objektiv. Siç del nga përmbajtja e shkresës, këto konkluzione bazohen në një informacion paraprak të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, dhe nuk janë rezultat i një vlerësimi tërësor e objektiv të punës, ashtu siç përcaktohet në pikën 8, të Kreut III, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, në të cilën thuhet se, në rast që marrja e vlerësimit të pjesshëm nga eprori i mëparshëm është i pamundur, zyrtari zëvendësues bazohet në vlerësimet e mëparshme.

Nga ana tjetër, vërehet se ato veprime ose mosveprime të nëpunëses së vlerësuar, përfshihen vetëm në pikën e parë të elementëve të procesit të vlerësimit, parashikuar në pikën 10, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, kurse për 6 (*gjashtë*) rubrikat e tjera nuk është bërë fjalë fare.

Për më tepër, konstatohet se mosrespektimi i kësaj procedure vlerësimi reflektohet dhe në mungesën e komenteve në rubrikat përkatëse të formularit të vlerësimit nga ana e Zyrtarit Raportues, por vetëm në shënjimin e numrit përkatës që i përket nivelit të vlerësimit për secilin prej zërave, në një kohë që është e detyrueshme të përmbaje dhe komentet përkatëse në lidhje me vlerësimin përfundimtar, arsyet e këtij vlerësimi si dhe rekomandimet apo vërejtjet e nevojshme, që duhen mbajtur parasysh në të ardhmen me qëllim rritjen e rezultateve dhe arritjen e objektivave më të larta.

Respektimi i këtij detyrimi ligjor, ndikon në një vlerësim objektiv dhe të matshëm, të performancës dhe arritjeve të nëpunësit civil gjatë kryerjes së detyrave të tij. Për më tepër, ky proces duhet të ndihmojë nëpunësen që në të ardhmen të përqëndrohet në ato drejtime të treguara, me qëllim përmbushjen sa më mirë të detyrave dhe nxitjen e rritjes së rezultateve në punë. Mos respektimi i procedurës së përcaktuar në aktin nënligjor, mungesa e dokumentacionit provues të zhvillimit të kësaj procedure dhe përdorimi i komenteve të njëjta

në të gjitha rubrikat, sjellin për rrjedhojë një vlerësim jo objektiv dhe jo të plotë, në lidhje me punën e kryer nga nëpunësi.

Sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë, është një proces i rëndësishëm, i cili konsiston në verifikimin e realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive dhe dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Ai i shërben përmirësimit të aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit dhe ka pasoja të rëndësishme për nëpunësin civil, pasi shërben për të marrë vendime objektive në lidhje me mundësinë e zhvillimit të karrierës nëpërmjet ngritjes në detyrë, lirim nga shërbimi, përparimin në hapat e pagës si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Për realizimin e një vlerësimi sa më objektiv, në kuptim të pikës 12, Kreut II, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i vazhdueshëm, për realizimin e të cilit, *Zyrtari Raportues*, duhet të kishte respektuar paraprakisht fazën e planifikimit, në të cilën ai përcakton objektivat kryesorë të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, etj.; në fazën e bisedimeve të ndërmjetme, në të cilën zyrtari raportues takohet me nëpunësin që do të vlerësohet për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë komente dhe fazën e vlerësimit përfundimtar, gjatë të cilit zyrtari raportues bën një vlerësim të përmbledhur të suksesit të nëpunësit.

Në kushtet konkrete të rastit në shqyrtim, kur zyrtari raportues që ka kaluar pjesën më të madhe të periudhës së vlerësimit me nëpunësin, nuk ka bërë vlerësimin e pjesshëm, siç kërkon pika 6, e Kreut III, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, bazuar në pikën 8, të aktit të mësipërm nënligjor, zyrtari zëvendësues duhet të kryejë vlerësimin duke u bazuar sidomos në vlerësimet e mëparshme dhe duke marrë në analizë, në mënyrë komplekse gjithë rrethanat dhe gjithë zërat e vlerësimit.

Për këto arsye:

Në zbatim të nenit 15 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, neneve 54 e 55, pikave *“d”* dhe *“dh”* të nenit 109 dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”* dhe neneve 16, pika 8 dhe 35, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, që të urdhërojë anulimin e aktit të vlerësimit/rivlerësimit të nëpunëses ***** (për periudhën 01.07.2020 - 31.12.2020), si një proces i kundraligjshëm dhe përsëritjen e procesit.
2. Njësia përgjegjëse duhet të kërkojë nga eprori direkt (*Zyrtari Raportues*), përsëritjen e procesit të vlerësimit, duke mbajtur parasysh respektimin e fazave të procesit dhe vërejtjet e përmendura në pjesën arsyetuese të vendimit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, lihet një afat 20 ditë nga komunikimi i vendimit.
4. Ky vendim ti komunikohet, Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe nëpunëses *****.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha